



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:260210

Datë: 28.03.2025

Numri i dokumentit: 07061542

PKR.nr.332/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – - Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Xhemajl JUSUFI, kryetar dhe Fatos SEJDIJAJ e Marigona LAJQI, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Arlind SADIKU, zyrtarja ligjore Doruntina BEKA, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: M.K, për shkak të veprave penale: I. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*) dhe II. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.3713/2019 e datës 31.08.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 06.03.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Fetije Bajrami, të akuzuarit M.K dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare avokat Isa Hyseni, me datë 10.03.2025 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 28.03.2025 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.K, nofka “M...”, nga i ati D..., e ëma M..., e vajzërisë J..., i lindur me datë ..., në Mitrovicë, ku edhe tani jeton në rrugën “..”, Mitrovicë Veriore, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, nuk udhëhiqen procedura tjera penale, me numër personal ..., serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

## I

Me datë 28.10.2019, rreth orës 15:30, në afërsi të “Tre rrokaqiejve” në Mitrovicë – Veri, pa autorizim, ka shitur substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, ashtu që, në afërsi të urës kryesore, në drejtim të “Tre rrokaqiejve” takohet me personin A.J dhe të njëjtit i shet në vlerë prej 10 euro substancën narkotike me peshë prej 0.52 gram që përmban heroinë të përzier me acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë, ndërsa gjatë kontrollit në shtëpi i është gjetur dhe sekuestruar edhe një sasi prej 0.48 gram që përmban heroinë të përzier me acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK-së.

## II

Nga data e pacaktuar e deri me datë 28.10.2019, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, ka mbajtur në posedim armën me hark, tojë apo tetivë, mekanizëm shigjete e thyer dhe jo-funksionale, e cila është sekuestruar nga njësia e DHTN-së.

Me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, 76, 267 e 366 të KPRK-së dhe neneve 276, 359, 360, 361, 364, 450, 463 të KPP-së, të akuzuarit i:

## C A K T O N

Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e tre (3) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (*me fjalë: pesëqind*) euro.

Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dënim me gjobë në shumë prej 300 (*me fjalë: treqind*) euro.

Gjykata, në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarit M.K i:

## S H Q I P T O N

I. Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e tre (3) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 800 (*me fjalë: tetëqind*) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

II. Në mbështetje të nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPP-së, Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike e llojit heroinë të përzier me Acetaminofen (Paracetamol) dhe kafeinë, me peshë neto  $1.00 \pm 0.0001$  gram dhe Urdhërohet Policia e Kosovës që të njëjtën ta shkatërrojë, sipas procedurave ligjore në fuqi, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

III. Në bazë të nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, Urdhërohet konfiskimi i armës – shigjetë dhe Urdhërohet që e njëjta të shkatërrohet nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

IV. Në mbështetje të nenit 270 paragrafi 1 të KPP-së, Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i telefonit Samsung me dy IMEI – 353...; 353..., me numra të vendosur +381... dhe +381..., që i përket të akuzuarit M.K. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, obligohet ta merr nën administrim sendin e konfiskuar. Agjencia, sipas ligjit, ka të drejtë që sendin e lartcekur (telefonin), ta administroj në përputhje me ligjin për Agjencinë.

V. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

VI. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

## A r s y e t i m

### Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur Aktakuzën PP.I.nr.3713/2019, të datës 31.08.2020, kundër, ndër të tjerë, të pandehurit M.K, për shkak të veprave penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata fillimisht rikujton se në këtë çështje penale, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2025, i pandehuri M.K e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas pikës I të aktakuzës dhe gjykata ka vazhduar me shqyrtim gjyqësor kryesor vetëm për pikën I të aktakuzës, ndërsa në raport me pikën II, gjykata kishte vendosur që aktgjykimin do ta shpallte kur të përfundonte çështja penale në tërësi dhe do të vendoste me një vendim të vetëm.

Gjithashtu në këtë aktakuzë, ishte i përfshirë si i pandehur edhe personi me emrin A.J, i cili akuzohej për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilin, gjyqtari që kishte lëndën paraprakisht, kishte veçuar procedurën penale dhe për të njëjtin kishte urdhëruar formimin e lëndës së re.

Gjykata ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 17.01.2025, 10.02.2025 dhe 06.03.2025, në të cilat kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari M.K dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Isa Hyseni. Në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për veprën penale që i vihej në barrë (pra për veprën penale sipas pikës I të aktakuzës), ndërsa gjykata ka dëgjuar dëshmitarin B.SH., ka administruar provat materiale, i pandehuri ka dhënë mbrojtjen e tij dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

### Fjala përfundimtare e palëve:

Në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit ka deklaruar se: pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre veç e veç dhe të gjitha së bashku, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale sipas pikës I të aktakuzës. Se i pandehuri e ka kryer veprën penale u vërtetua nga deklarata e dëshmitarit B.SH. – zyrtar policor i njësitit DHTN, i cili ka deklaruar se i kujtohet se atë ditë e kanë vërejtur personin që kanë shkëmbyer diçka tek dritarja e automjetit Alfa Romeo, i pandehuri Millosh ishte nisur rrugës së veriut, ndërsa A.J. e ka ndalë policia dhe i njëjti është munduar të gjuajë diçka nga dora, pastaj kur janë afruar policia e kanë gjetur një qese me substancë narkotike dhe i njëjti ka deklaruar se atë substancë e ka blerë në shumë prej 10 euro nga personi me emrin Muki, ndërsa policia atë ditë pas marrjes së urdhrorit nga gjykata kanë kontrolluar banesën e të pandehurit dhe i kanë gjetur një sasi të narkotikëve dhe një armë dhe një telefon, ndërsa nga ekspertiza është konstatuar se dëshmia 2 ka përmbajtur heroinë të përzier me acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë me peshë neto  $1.00 \pm 0.0001$  gram. Se i pandehuri e ka kryer veprën penale është vërtetuar edhe nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i datës, nga ekspertiza e narkotikëve dhe ekzaminimi i telefonave, e që u vërtetua se me datë 28.10.2019 rreth orës 15:23 minuta i pandehuri M.K nga numri i tij kishte komunikuar me numrin 043866018 e që ai numër ishte pronë e të pandehurit A.J. . Ka theksuar se edhe pse i pandehuri është munduar të mohoj veprën penale, me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, nga të gjitha provat është vërtetuar se i njëjti i ka shitë narkotikë personit A.J nga i cili ka marrë para në shumë prej 10 euro. Gjykatës i ka propozuar që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe të njëjtit të shqiptoj një sanksion penal më të cilin në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë rënduese të merr parasysh peshën e veprës penale, dashjen e të pandehurit, përfitimin personal dhe faktin se kjo është substancë e rrezikshme për shëndetin e njerëzve.

Mbrojtësi i të pandehurit M.K, avokat Isa Hyseni, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: pas administrimit të provave personale dhe materiale, është vërtetuar pafajësia e të mbrojturit të tij, ku i mbrojturi i tij në shqyrtim gjyqësor me bindje dhe besueshmëri ka deklaruar se nuk ka shitur narkotikë, ndërsa çështja është për një pluhur të cilin ua jep qenve të tij për mjekim, të cilët i mban në shtëpinë e tij dhe se këtë pluhur e ka blerë në barnatore. Ka theksuar se dëshmitari B.SH gjatë dëshmisë së tij ka deklaruar për të mbrojturin e tij se është i njohur për policinë, ndërsa në bazë të dosjes personale nuk ka të kaluar kriminale, gjithashtu lidhur me kontrollin e ndërmarrë me datë 28.10.2019 në ora 16:14 në shtëpinë e të mbrojturit të tij, në

procesverbal askund nuk ceket që i dyshuari ka refuzuar që gjatë kontrollit të marrë pjesë avokati dhe është cenuar dispozita e nenit 107 paragrafi 1 e 2 të KPP-së, po ashtu kontrolli është kryer pa prezencën e dy dëshmitarëve dhe është kryer në kundërshtim me nenin 108 paragrafi 2 të KPP-së, e këto të meta e përbëjnë këtë provë të papranueshme. Lidhur me provat materiale – thirrjet telefonike, nuk mund të konstatohet përmbajtja e bisedës dhe askush nuk mund të inkriminohet kur ekzistojnë mëdyshje për faktet. Gjithashtu nga fakti se vet pluhuri i gjetur është i sasisë së vogël, konsiderojmë që në këtë çështje penale i mbrojturi im është i pafajshëm andaj edhe kërkojmë aktgjykim lirues, ndërsa lidhur me pikën II të aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese, faktit se është person familjar, i padënuar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij dhe ka shtuar se nuk e njeh personin me emrin A., po ashtu as nofkën nuk e ka M...

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 06.03.2025, gjykata ka dëgjuar dëshmitarin B.SH., i cili ndër të tjera ka deklaruar se qëndron prapa raporteve zyrtare, duke qenë se ka kaluar kohë e gjatë dhe mund të harrojë ndonjë detaj, por atë ditë A.J. n e ka parë tek ura kryesore i cili ka qenë duke shkuar në drejtim të “Tre Rrokaqiejve” ndërsa dëshmitari ka theksuar se i ka qëndruar në shikim vizuel për Agimin sepse i njëjti edhe më herët ka pasur raste për narkotikë. Ka theksuar se në afërsi të rrethit që gjendet tek tre rrokaqiejt, ka ardhur vetura Alfa Romeo ngjyrë hiri dhe në të ka qenë një person i njohur për policinë në bazë të informatave inteligjente dhe aty personi A.J është afruar tek xhami i vozitësit dhe menjëherë i ka njoftuar zyrtarët tjerë përmes telefonit se u shkëmbye diçka e dyshimtë mes Agimit dhe vozitësit, pastaj vozitësi ka vazhduar në drejtim të spitalit, ndërsa Agimi është nisur në drejtim të urës kryesore për të kaluar në jug, ku aty bashkë me zyrtarët tjerë e kanë ndaluar dhe ai ka hedhë diçka në tokë dhe ajo çka ka hedhë ka qenë substancë e dyshuar narkotike, pastaj Agimin e kanë shoqëruar në stacion policor dhe i njëjti ka deklaruar që atë substancë e ka blerë në vlerë prej 10 euro prej personit me nofkën Muki që voziste veturën Alfa Romeo. Ka deklaruar se atë ditë e kanë marrë urdhrin verbal të gjyqtarit për kontroll dhe kanë kontrolluar shtëpinë e M.K i cili ka qenë edhe vozitës i veturës Alfa Romeo dhe të njëjtin e ka identifikuar sepse ka qenë në distancë të afërt, të mjaftueshme për ta identifikuar, ndërsa gjatë kontrollit në shtëpinë e tij edhe pse i njëjti ka kundërshtuar hyrjen e zyrtarëve policor, kanë gjetur një sasi të substancës narkotike dhe një armë/shigjetë.

Pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale, i pandehuri ka dhënë mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor, duke theksuar se nuk e njeh personin A.J dhe nuk e ka parë kurrë, se shtëpia e tij është kontrolluar nga policia dhe para kontrollit nuk është njoftuar për të drejtat që i takojnë dhe se nuk kanë marrë pjesë dy dëshmitarë, e gjatë kontrollit i kanë marrë shigjetën dhe një pluhur të kombinuar i cili shërben për trajtimin e lëndimit të qenve për shkak se i pandehuri kultivon qenë për dyluftime dhe atë pluhur e ka blerë në barnatore afër spitalit, ndërsa drogë nuk i ka shitur askujt asnjëherë, gjithashtu ka theksuar se as nuk e konsumon. Ka deklaruar se gjatë vitit 2019 e edhe më tutje e posedon veturën Alfa Romeo ngjyrë hiri me targa KM-....., ndërsa me datë 28.10.2019 nuk ka qenë duke vozitur afër tre rrokaqiejve. Ka theksuar se nuk ka biseduar asnjëherë në telefon me A.J. n.

Provat e administruara:

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike administroi provat si në vijim: Raporti policor i datës 28.10.2019 i hartuar nga zyrtar policor B.SH; Referenca e datës 29.10.2019 e hartuar nga zyrtari policor M.T; shënimi zyrtar i datës 28.10.2019 sipas referencës 06/2-02/3001/19; procesverbali mbi kontrollin e datës 28.10.2019; lista e dëshmimeve datë 28.10.2019; raporti nga shikimi i vendit të ngjarjes i datës 28.10.2019 i hartuar nga A.N dhe M.L; foto dokumentacioni; lista e gjërave të konfiskuara e datës 28.10.2019; lista e sendeve të konfiskuara e datës 28.10.2019; raporti i ekspertizës së substancës narkotike AKF-2019-3096/2019-2739 datë 25.11.2019; raporti i ekspertimit të telefonave AKF-2019-0451 datë 04.01.2020.

Vlerësimi i Gjykatës për pikën I të dispozitivit, vepra penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat me kujdes dhe vëmendje, një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 360 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në këtë çështje penale, nuk ishte kontestues fakti se i pandehuri A.J. , ndaj të cilit është veçuar procedura penale, ditën kritike ka qenë në Mitrovicë të Veriut si dhe tek i njëjti gjatë kontrollit është gjetur dhe sekuestruar një sasi e substancës narkotike e llojit heroinë, fakt ky që vërtetohet

në bazë të raporteve policore të datës 28.10.20219; deklaratës së dëshmitarit B.SH. dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 06.03.2025; foto-dokumentacioni, si dhe vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve nga A.J. .

Nuk ishte kontestues fakti se tek i akuzuari M.K, gjatë kontrollit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse, ishte gjetur një substancë e dyshuar, e cila në bazë të ekspertizës nga AKF me nr. ref. AKF-2019-3096/2019-2739 datë 25.11.2019 rezulton që përmban heroinë. Një fakt të tillë (se substanca e tillë është gjetur tek i akuzuari) nuk e mohon as vet i akuzuari, por thekson se ajo substancë është një pluhur që e përdor për qentë e tij dhe të cilin e blen në barnatore. Gjithashtu fakti i tillë vërtetohet nga procesverbali për zbatimin e kontrollit i datës 28.10.2019 dhe nga foto-dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës si dhe vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve nga i pandehuri M.K.

Nuk ishte kontestuese se pronar i veturës Alfa Romeo, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit KM-....., ishte pikërisht i pandehuri M.K i cili edhe në shqyrtim gjyqësor e ka pohuar këtë fakt.

Kontestuese në këtë çështje penale ishte fakti se i akuzuari M.K, a i kishte shitur substancë e cila me ligj është shpallur si narkotikë personit A.J në lokacionin tek “Tre Rrokaqiejt” – Mitrovicë e Veriut.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari me datë 28.10.2019, rreth orës 15:30, në afërsi të “Tre Rrokaqiejve” në Mitrovicë – Veri, pa autorizim, ka shitur substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, ashtu që, në afërsi të urës kryesore, në drejtim të “Tre rrokaqiejve”, takohet me personin A.J dhe të njëjtit i shet në vlerë prej 10 euro substancën narkotike me peshë prej 0.52 gram që përmban heroinë të përzier me acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë, ndërsa gjatë kontrollit në shtëpi i është gjetur dhe sekuestruar edhe një sasi prej 0.48 gram që përmban heroinë të përzier me acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë.

Këtë gjendje faktike, Gjykata e ka vërtetuar duke u bazuar në provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor si dhe nga deklaratat e dëshmitarit B.SH. dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Nga deklaratat e dëshmitarit B.SH. dhënë në shqyrtim gjyqësor, Gjykata ka vërtetuar faktin se ditën kritike, personi A.J ka qenë duke lëvizur prej urës kryesore në drejtim të “Tre



Rrokaqiejve” në Mitrovicë Veri dhe se derisa i njëjti ka qenë tek ai lokacion, aty ka arritur vetura Alfa Romeo, ngjyrë hiri dhe vozitësi i asaj veture ka shkëmbyer diçka me A.J., ndërsa Agimi më pas është nisur në drejtim të urës kryesore ku edhe e kanë ndaluar bashkë me zyrtarët tjerë policorë dhe tek i njëjti kanë gjetur një substancë të dyshuar narkotike, ndërsa pas dhënies së urdhrit verbal nga gjyqtari i procedurës paraprake, kanë kontrolluar shtëpinë e të akuzuarit M.K, ku gjatë kontrollit kanë gjetur një sasi të substancës së dyshuar narkotike si dhe një armë/shigjetë. Dëshmitari ka theksuar se duke qenë se ishte në distancë të afërt në momentin kur A.J ka shkëmbyer diçka (në këtë rast substancën narkotike) me vozitësin e veturës Alfa Romeo (të akuzuarin M.K) ka arritur të identifikojë të akuzuarin.

Gjykata i ka falur besimin deklaratës së dëshmitarit B.SH, duke qenë se deklarata e e të njëjtit është në përputhje edhe me provat tjera materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor dhe se nuk ka ndonjë kundërtënie të cilat do ta vënin në dyshim besueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit. Deklarata e këtij dëshmitari, ishte konsistente në raport edhe me provën e administruar, përkatësisht raportin policor të datës 28.10.2019, të përpiluar pikërisht nga ky dëshmitar, në cilësinë e zyrtarit policor, ditën e ngjarjes. Për më tepër, gjykata nuk ka asnjë mëdyshje lidhur me besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit, në kontekst të saj që sikurse raportin policor, ashtu edhe dëshminë e tij në gjykatë, dëshmitari i ka dhënë në cilësi të zyrtarit policor, përkatësisht si hetues në kuadër të drejtorisë kundër narkotikëve, pra në kuadër të detyrave të punës zyrtare që bënë dëshmitari, andaj për këto arsye, gjykata ia ka falur në tërësi besimin dëshmisë së dëshmitarit.

Përveç deklaratës së dëshmitarit B.SH. që thekson faktin se i akuzuari M.K në lokacionin tek “Tre Rrokaqejt” është takuar me A.J. dhe në atë moment i ka shitur substancën narkotike, një fakt i tillë vërtetohet nga listingu i thirrjeve të pranuar në numrin e telefonit të të akuzuarit M.K, ku me datë 28.10.2019 i akuzuari M.K pranon disa thirrje nga A.J., i cili kishte në posedim numrin e telefonit 043..., e që fillimisht, në ditën kritike me datë 28.10.2019, rreth orës 13:33 zhvillojnë një bisedë në kohëzgjatje prej 14 sekonda, e më pas rreth orës 15:23 minuta, i akuzuari sërish pranon thirrje nga numri i telefonit të A.J dhe bisedojnë për rreth 20 sekonda. Pikërisht pas kësaj thirrjeje, i akuzuari takohet me A.J. në lokacionin tek “Tre Rrokaqejt” dhe i shet substancën narkotike.

Gjithashtu, një fakt i tillë vërtetohet edhe në bazë të raporteve policore të datës 28.10.2019 nga të cilat rezulton se zyrtarët policorë, në afërsi të urës kryesore në Mitrovicë Veri, kanë ndaluar

personin A.J dhe tek i njëjti gjatë kontrollit është gjetur një substancë e dyshuar narkotike, e cila pas ekzaminimit nga AKF rezulton që përmban heroinë të përzier me acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë.

Ndërlidhur me këtë që u tha më lartë, gjatë kontrollit të shtëpisë tek i akuzuari M.K, është gjetur dhe sekuestruar substancë e dyshuar narkotike, e cila pas ekzaminimit nga AKF rezulton që përmban heroinë të përzier me acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë, e që është në përmbajtje e njëjtë me substancën narkotike të sekuestruar nga A.J. . Kjo ndërlidhje e fakteve të vërtetuara nga Gjykata, e në raport edhe me deklaratën e dëshmitarit B.SH. dhe raportet policore, nga të cilat rezulton se A.J., te lokacioni tek “Tre Rrokaqiejt”, është takuar me një person që ka ardhur aty me veturën “Alfa Romeo” ngjyrë hiri dhe nga dritarja e vozitësit kanë shkëmbyer diçka, vërteton faktin se këtu i akuzuari, i ka shitur substancën narkotike A.J.

Mbrojtja e të akuzuarit:

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e paraqitur nga i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor me datë 06.03.2025, ku i njëjti ka theksuar se A.J. nuk e ka njohur asnjëherë dhe nuk e ka parë kurrë, gjatë kontrollit të shtëpisë i janë gjetur një shigjetë dhe një pluhur i kombinuar që shërben për trajtimin e lëndimit të qenve të cilin e ka marrë në barnatore, ndërsa A.J. nuk i ka shitur kurrë narkotikë. Ka theksuar se edhe gjatë vitit 2019 e edhe tani e ka në posedim automjetin Alfa Romeo, ngjyrë hiri me targa KM-....., si dhe asnjëherë nuk kam komunikuar në telefon me A.J.

Gjykata vlerëson se deklaratimet e të akuzuarit janë kretësisht të pabesueshme dhe me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale dhe gjithashtu në kundërshtim me provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor, duke qenë se i akuzuari thekson se nuk e njeh personin me emrin A.J dhe se asnjëherë nuk ka komunikuar me atë, e që një fakt i tillë i kundërt, është vërtetuar në bazë të listingut të thirrjeve të pranuar në numrat e telefonit të cilët i kishte në posedim i akuzuari M.K, dhe atë me datë 28.10.2019 kishte biseduar dy herë me A.J. n që atë kohë kishte në posedim numrin e telefonit 043..., dhe atë vetëm rreth 5 minuta para se të takoheshin tek “Tre Rrokaqiejt” në Mitrovicë Veriore, ku edhe i akuzuari i shet narkotikun A.J.

Neni 267 paragrafi 2 i KPRK-së, ka përcaktuar si në vijim: “*Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca*

*analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.”*

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i akuzuari M.K, kishte ndërmarr veprimet në drejtim të kryerjes së veprës penale, ashtu që ditën kritike, rreth orës 15:30, në afërsi të “Tre rrokaqiejve” në Mitrovicë – Veri, ka shitur substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, ashtu që, në afërsi të urës kryesore, në drejtim të “Tre rrokaqiejve” takohet me personin A.J dhe të njëjtit i shet në vlerë prej 10 euro substancën narkotike me peshë prej 0.52 gram që përmban heroinë të përzier me acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë.

Veprimet e tilla të të akuzuarit si të tilla janë të kundërligjshme, duke qenë se substanca e tillë të cilën i akuzuari e ka shitur tek A.J., me ligj është shpallur si narkotik dhe shitja pa autorizim e një substancë të tillë ashtu siç edhe përcaktohet në dispozitën e nenit 267 paragrafi 2 të KPRK-së, është veprim i kundërligjshëm pasi që nuk lejohet disponimi me substanca të tilla, të cilat cenojnë shëndetin e njeriut e që përbënë edhe objektin mbrojtës të kapitullit të veprave penale kundër narkotikëve.

Nga dispozita e lartcekur, rezulton se vepra penale sipas nenit 267 paragrafi 2 të KPRK-së, mund të kryhet në mënyrë alternative dhe atë nëse shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge.

Në rastin konkret, i akuzuari ka shitur tek personi A.J substancën narkotike në të cilën në bazë të ekspertizës rezulton se është prezent heroina, si substancë me rrezikshmëri të lartë që është e ndaluar për përdorim sipas Ligjit Nr.02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ndaj të akuzuarit M.K duke e shpallur të njëjtin fajtor, pasi që në bazë të provave të administruara, u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit, janë përmbushur të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së.

Trupi gjykues në këtë rast, nuk ka marr për bazë pretendimet e mbrojtjes se kontrollimi i shtëpisë së të pandehurit në ditën kritike, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 107 dhe 108 të KPP-së dhe se kjo provë materiale, duhet të shpallet si provë e pranueshme bazuar në dispozitën e nenit 111, paragrafi 6 dhe 7 të KPP-së.

Kjo për arsye sepse sipas dispozitave procedurale të cilat ishin në fuqi në kohën kur janë ndërmarrë veprimet hetimore (Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale) në rastin konkret, lejonin që në raste specifike, të kryhej kontrolli i shtëpisë apo lokaleve të personit edhe pa urdhër të (shkruar) gjykatës si dhe pa siguruar prezencën e dëshmitarëve.

Kështu, paragrafi 3 i nenit 110 të KPP-së në fuqi në atë kohë, përcaktonte se: *“3. Përjashtimisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, zyrtari i autorizuar i policisë mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari kompetent.”*, ndërsa paragrafi 4 i të njëjtit nen përcaktonte se: *“4. Përjashtimisht, kontrolli mund të zbatohet pa praninë e dëshmitarëve nëse prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë dhe vonesa e fillimit të kontrollit do të ishte e rrezikshme. Arsyet për zbatimin e kontrollit pa praninë e dëshmitarëve shënohen në procesverbal.”*. Në rastin konkret, nuk është kontestuese se sipas procesverbalit, gjatë kontrollit të shtëpisë së të pandehurit, nuk kishte dëshmitar prezent, mirëpo sipas paragrafi 5 të nenit 110 të KPP-së, në rastet kur, ndër të tjera, ekziston dyshim i bazuar se personi mund të mënjanojë, fshehtë apo asgjësojë sendet të cilat nga ai duhet të merren si provë në procedurë penale, kontrolli mund të zbatohet edhe pa urdhër të gjykatës dhe pa praninë e dëshmitarëve. Kjo dispozitë përcakton se: *“5. Policia mund të zbatojë kontrollin e personit pa urdhër ose pa praninë e dëshmitarëve kur ekzekuton aktvendimin për sjelljen forcërisht të personit ose kur bën arrestimin e tij, nëse ekziston dyshim i bazuar se personi mban armë apo ndonjë mjet për sulm ose kur mund të mënjanojë, fshehtë apo asgjësojë sendet të cilat nga ai duhet të merren si provë në procedurë penale.”*. Në rastin konkret, veprimet e policisë kanë qenë plotësisht të ligjshme dhe në harmoni me urgjencën e çështjes, marr parasysh faktin se gjatë kontrollit të shtëpisë së të pandehurit, janë gjetur një armë/shigjetë si dhe një sasi e substancës narkotike dhe përveç kësaj, zbatimi i kontrollit të shtëpisë së të pandehurit, ka ardhur si pasojë e asaj që paraprakisht, i pandehuri i kishte shitur një sasi të substancës narkotike personit me emrin A.J andaj edhe veprimet e policisë, kanë qenë në përputhje me rrethanat e rastit konkret.

Megjithatë për veprimet e lartcekura, me qëllim legjitimitimin e tyre, dispozita e nenit 110, paragrafi 6 të KPP-së, kishte përcaktuar detyrimin e policisë që për këto veprime, të njoftohet

prokurori i shtetit si dhe gjyqtari i procedurës paraprake, me qëllim lëshimin e urdhrin për konfirmim retroaktiv të kontrollit, e që në këtë rast edhe kishte ndodhur pasi që kontrolli i kryer te i pandehuri M.K, ishte konfirmuar nga gjyqtari i procedurës paraprake përmes Urdhrit me numër UGJK.nr.65/19, të datës 29.10.2019.

Nuk qëndron as pretendimi i mbrojtjes se të pandehurit i janë shkelur të drejtat sa i përket të drejtës që i takon personave për prezencën e avokatit gjatë zbatimit të kontrollit. Kjo sepse nëse vështrohet me kujdes procesverbali i kontrollit të shtëpisë së të pandehurit, i datës 28.10.2019, vërehet se i njëjti është njoftuar me të drejtat e tij dhe se një nga të drejtat me të cilat është njoftuar, ka qenë edhe fakti se i njëjti ka të drejtë të kontaktoj me avokatin e tij, të cilin procesverbal (të kontrollit) i pandehuri e ka nënshkruar e që nënkupton se edhe është njoftuar për të drejtat e tij.

Gjykata, pas administrimit të provave materiale, e ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike për të akuzuarin M.K, në raport gjendjen faktike të vërtetuar. Gjendja faktike është ndryshuar pas administrimit të të gjitha provave. Në këtë kontekst, përshkrimi i gjendjes faktike është ndryshuar vetëm në raport me sasinë e narkotikut të gjendur te i pandehuri dhe të sasisë që i njëjti ia ka shitur A.J., pasi që në aktakuzën e dorëzuar nga prokuroria, përshkrimi i sasisë së narkotikut ishte bërë duke u bazuar në listën e gjerave të konfiskuara nga të pandehurit, lista këto të datës 28.10.2019, ndërsa që gjykata, përshkrimin e sasive të narkotikut të konfiskuara nga i pandehuri, e ka bërë duke u bazuar në raportin e ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-AKF me numër Referues AKF-2019-3096/2019-2739 i datës 25.11.2019 i cili raport ka përcaktuar edhe peshën neto për secilën sasi të narkotikut të gjendur te i pandehuri dhe te personi të cilit i pandehuri ia ka shitur narkotikun, A.J. Gjykata, në përshkrimin e gjendjes faktike nuk ka ndryshuar identitetin subjektiv të veprës penale, nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale lidhur me kohën, vendin, të pandehurin, mënyrën e kryerjes së veprës penale, përveç se ka ndryshuar, siç u theksua më lart, sasinë e narkotikut të gjendur te i pandehuri dhe personi të cilit i pandehuri ia ka shitur narkotikun. Andaj gjykata e ka përshkruar gjendjen faktike ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

*Vlerësimi i Gjykatës për pikën II, vepra penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së:*

Sipas pikës II të aktakuzës, i pandehuri është akuzuar për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

I akuzuari M.K, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2025, e ka pranuar në tërësi fajësinë për këtë pikë të aktakuzës.

Gjykata, pasi dëgjoji mendimin e palëve, ku edhe prokurori edhe mbrojtësi propozuan që të pranohet fajësia e deklaruar nga i akuzuari për këtë pikë, e shqyrtoi pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri, gjykata në këtë drejtim vlerësoi se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raportet policore të datës 29.10.2019; foto dokumentacioni; procesverbali mbi kontrollin i datës 28.10.2019; raporti nga shikimi i vendit të ngjarjes i datës 28.10.2019; lista e gjërave të konfiskuara dt.28.10.2019; Raporti i ekspertimit nga AKF me nr. ref. AKF/2025-0296/25-277 i datës 30.01.2025. Të gjitha këto prova janë bindëse për Gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, por mund të ushtrojë ankesë vetëm sa i përket sanksionit penal, Gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, Gjykata ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet, pasi që ka vlerësuar se në veprimet e të pandehurit janë konsumuar të gjitha elementet, qoftë objektive e po ashtu edhe ato subjektive, të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor.

#### Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.

Si rrethana rënduese, Gjykata pati parasysh dashjen e lartë të pandehurit për kryerjen e kësaj veprë penale, ashtu që i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij të kundërligjshme, si dhe rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale në kontekst të saj se ky lloj i veprave penale, është në rritje në vendin tonë. Ndërsa, si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi, pranimin e fajësisë të të akuzuarit lidhur me pikën II të dispozitivit të aktakuzës; sjelljen korrekte të akuzuarit gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe faktin se më herët nuk ka qenë i dënuar për veprë penale.

Gjykata, duke marrë për bazë rrethanat lehtësuese të cekura si më lartë, e sidomos faktin se i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar, vendosi që ndaj të njëjtit të shqiptojë dënimin me burgim nën minimumin e paraparë ligjor për veprën penale sipas pikës një (I) të dispozitivit, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 lidhur me nenin 72, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, në të cilën përcaktohet se :*“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej dy (2) vjet, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë (6) muaj burgim”*.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t’i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Në lidhje me dënimin me gjobë të shqiptuar ndaj të pandehurit, Gjykata ka marrë parasysh rrethanat e përmendura më lart dhe kushtet ekonomike të tij. Pas vlerësimit të mundësive materiale të të pandehurit, Gjykata ka vendosur që ky dënim me gjobë është i përballueshëm për të dhe se ai do të ketë efektin e duhur në ndalimin e veprave të ngjashme në të ardhmen.

#### Vendimi për konfiskim:

Në mbështetje të nenit 267, paragrafi 5 dhe nenit 366, paragrafi 3 të KPRK-së, lidhur me nenin 276, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.4 të KPP-së, Gjykata ka urdhëruar konfiskimin e substancës narkotike dhe armës shigjetë të përshkruar si në dispozitiv të Aktgjykimit. Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri nuk ka poseduar leje apo autorizim për posedimin e narkotikëve dhe të armës. Për më tepër, sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë

automatike. Andaj edhe ka vendosur që t'i konfiskoj përherë këtë sasi të narkotikëve dhe armën shigjetë, si dhe ka urdhëruar shkatërrimin e tyre.

Vendimi për konfiskimin e telefonit të pandehurit:

Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij Aktgjykimi ashtu që ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të telefonit Samsung me dy IMEI – 353...; 353..., me numra të vendosur +381... dhe +381..., pronë e të pandehurit, duke u bazuar në nenin 270 paragrafi 1 të KPP-së, i cili përcakton si në vijim: “1. Para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që ishte mjet, prokurori i shtetit e provon në shqyrtimin kryesor se pasuria ishte mjet i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar”, e lidhur me nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.38, pika 1.38.4 të KPP-së, duke vlerësuar se mjete, përkatësisht telefoni i përdorur nga i pandehuri, i ka shërbyer të njëjtit vënien e kontaktit/komunikimit me personin A.J me qëllim shitjen e narkotikut dhe caktimin e lokacionit për takim, e që sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, kjo ka lehtësuar kryerjen e veprës penale nga i pandehuri.

Vendimi për shpenzimet e procedurës:

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, në aktakuzë nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Andaj Gjykata, duke u bazuar në nenin, 359, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsytet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.332/2020, datë 28.03.2025

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.